



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

RAPORTI

EKONOMIKO-FINANCIAR DHE ZBATIMIN E PLANEVE INVESTIVE TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN

JANAR-QERSHOR 2014

Qershor, 2014

PASQYRA E ARKËTIMIT TË TË HYRAVE

Komuna e Prishtinës për vitin 2014, ka një buxhet të miratuar në vlerë prej 63,443,190 Euro. Nga këto mjete, 24,318,250 Euro (apo 38.3%) vijnë nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër nga granatet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi).

Në periudhën janar – qershor 2014, Komuna e Prishtinës ka arkëtuar gjithsej 9,289,706.87 € të hyra vetanake. Shumica e të hyrave, në vlerë absolute, janë nga taksat për leje ndërtimi dhe nga tatimi në pronën e paluajtshme.

Realizimi i të hyrave është relativisht i kënaqshëm sa i përket tatimit në pronën e paluajtshme (59%), taksës për shërbime arsimore (55.9%), taksës për certifikata dhe dokumente zyrtare (53.5%), taksës për automjete motorike (52.5%), gjobave në trafik (50.4%).

Realizimi i të hyrave nga taksa për leje ndërtimi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, është në shkallën prej 24.5%. Arsyeja kryesore për këtë nivel të ulët të realizimit është se një numër i lejeve të ndërtimit që janë dhënë vitin e kaluar, prej të cilave është pritur arkëtimi në këtë gjashtëmujor, janë pezulluar për shkak të parregullsive të gjetura në këto leje. Gjithashtu duhet të përmendet edhe fakti që numri i kërkesave në këtë periudhë për leje ndërtimi, ka qenë më i vogël në krahasim me vitin 2013.

Realizimi i të hyrave nga taksa për shfrytëzimin e sipërfaqes publike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, është në shkallën prej 18.1% dhe kjo pritet të rritet në sezonin e verës, për shkak se këto të hyra janë kryesisht të ndërlidhura me sezonin veror.

Të hyrat nga inspekcioni janë gjithashtu në shkallë të ulët prej 0.3%, kjo për shkak se të hyrat e mundshme janë praktikuar jo gjobat mandatorë, por ato procedura përmes gjykatës.

Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, ky nivel i arkëtimit është për 12.5% më i ulët. Në tabelën në vijim janë paraqitur të gjitha burimet e të hyrave dhe janë dhënë krahasimet me vitin paraprak.

Tabela 1: Krahasimi i planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar - qershor 2013 dhe 2014.

Periudha krahasuese janar - qershor 2013-2014								
Nr	PËRSHKRIMI	2013			2014			Krahasimi 13/14
		Planifikimi	Realizimi	%	Planifikimi	Realizimi	%	
1	Taksa për leje ndërtimi	12,180,000.00	5,471,535.67	44.92	13,200,000.00	3,238,075.54	24.53	(40.82)
2	Tatimi në pronën e paluajtshme	4,500,000.00	2,046,648.17	45.48	4,600,000.00	2,712,086.63	58.96	32.51
3	Licenca në biznes	-	10,645.50	-	-	42,275.00	-	297.12
4	Taksa për shfrytëzimin e sip. publike	1,300,000.00	318,258.15	24.48	1,450,000.00	261,856.27	18.06	(17.72)
5	Infrastruktura rrugore	-	25,134.00	-	-	23,556.57	-	(6.28)
6	Taksa nga kadastru dhe gjeodezia	450,000.00	275,921.06	61.32	550,000.00	247,508.41	45.00	(10.30)
7	Taksa për transakcion në pronë	560,000.00	314,250.00	56.12	650,000.00	237,250.00	36.50	(24.50)
8	Të hyra nga inspektioni	100,000.00	15,900.00	15.90	150,000.00	470.00	0.31	(97.04)
9	Taksa për certifikatë dhe dokumente zyrtare	237,920.00	105,492.50	44.34	248,250.00	132,750.00	53.47	25.84
10	Taksa për automjete motorike	420,000.00	272,146.00	64.80	500,000.00	262,300.00	52.46	(3.62)
11	Taksa për shërbime arsimore	980,000.00	665,280.17	67.89	1,200,000.00	670,517.50	55.88	0.79
12	Taksa për shërbime shëndetësore	210,000.00	97,791.70	46.57	250,000.00	116,328.90	46.53	18.96
13	Gjobat në trafik	600,000.00	129,375.55	21.56	650,000.00	327,278.00	50.35	152.97
14	Qiraja e banesave dhe renta	-	343,812.83	-	-	72,748.14	-	(78.84)
15	Të hyrat nga "Hortikultura"	-	162,637.00	-	-	125,530.00	-	(22.82)
16	Participime / Donacione	70,000.00	299,580.74	427.97	400,000.00	3,600.00	-	(98.80)
17	Të hyrat tjera	150,000.00	4,148.98	2.77	470,000.00	-	-	(100.00)
18	Shitja e pasurisë	-	52,812.97	-	-	2,707.49	-	(94.87)
19	Agjencia e pyjeve	-	2,816.85	-	-	768.42	-	(72.72)
20	Gjobat nga gjykatat	-	-	-	-	-	-	-
21	Shpronësime	-	-	-	-	812,100.00	-	-
	Gjithsej	21,757,920	10,614,187.84	48.78	24,318,250	9,289,706.87	38.20	(12.48)

* Faturimi për tatimin në pronë për vitin 2014 është 5.427.802,13 Euro

Detyrimet ndaj Komunes së Prishtinës, përkatësisht të hyrat e arkëtuara, janë si në vijim: për tatim në pronën e paluajtshme 35,986,000 Euro¹, taksa për leje ndërtimi 6,938,041.84 Euro dhe shpronësimet nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor 7,676,292.55 Euro. Në lidhje me këto të hyra, pritet të kemi rritje të konsiderueshme të arkëtimit gjatë pjesës së dytë të vitit 2014.

¹ Vlera e paraqitur është nga data 31.12.2013 nga pasqyrat financiare për vitin 2013.

PASQYRA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR - QERSHOR 2014

Komuna e Prishtinës ka shpenzuar gjithsej 34.7% të buxhetit të miratuar për vitin 2014. Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është në shkallën prej 55.3%, për mallra dhe shërbime prej 30.9%, për shpenzime komunale 46.8%, për subvencione 17.5% dhe shpenzime kapitale 19.6%.

Në krahasim me vitin 2013, Komuna e Prishtinës ka realizuar buxhetin e vitit 2014 për 4.66% më shumë.

Tabela 2: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën janar - qershor 2013-2014

Programi	2013					2014				
	Buxheti	Bartja-2012	Totali	Shpenzimi	%	Buxheti	Bartja-2013	Totali	Shpenzimi	%
Paga dhe mëditje	22,180,000	-	22,180,000	11,137,659	50.21	22,237,317	24,395	22,261,712	12,298,957	55.25
Mallra dhe shërbime	7,248,432	314,759	7,563,191	2,989,531	39.53	10,282,442	704,206	10,986,648	3,180,221	28.95
Shpenzime komunale	1,605,000	-	1,605,000	762,858	47.53	1,760,431	-	1,760,431	824,559	46.84
Subv.dhe trans.	1,000,000	550,000	1,550,000	969,699	62.56	1,595,000	50,000	1,645,000	279,545	16.99
Investimet kapitale	31,338,299	20,462,040	51,800,339	8,590,339	16.58	27,568,000	13,833,563	41,401,563	5,414,052	13.08
Gjithsejt	63,371,731	21,326,799	84,698,530	24,450,087	28.87	63,443,190	14,612,164	78,055,354	21,997,334	28.18

Shpenzimet kapitale pritet të rriten në pjesën e dytë të vitit, pasi që shumica e pagesave për shpenzimet në projekte kapitale realizohen gjatë pjesës së dytë të vitit.

RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS PËR 2013²

Në qershor 2014, Komuna e Prishtinës e ka pranuar Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2013. Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2013, i cili e përcakton opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të vitit 2013 është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e shpalosura mbi pasuritë fikse dhe klasifikimin e shpenzimeve nuk ishin të plota dhe të sakta:

Pasuritë me vlerë mbi 1000€ në Pasqyra Vjetore Financiare ishin prezantuar me një total prej 2,501,447,000€, kurse në regjistrin kontabël vetëm 85,006,000€. Gjithashtu, pasuritë me vlerë nën 1000€ me një total prej 633,000€, nuk ishin përfshirë në Pasqyra Vjetore Financiare.

Poashtu, komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve, ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte bërë pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 307,220€.

² http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPR_2013_Shqip_77141.pdf

Çështje tjera

Obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në vlerë prej 44,577€ nuk ishin prezantuar në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2013, kurse ishin paguar në 2014, si dhe në bilancin e llogarive të arkëtueshme nuk ishte përfshirë taksa për leje të veprimtarisë së biznesit

(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Bazuar në këtë raport, konkluzioni nga Auditori i Përgjithshëm është se menaxhmenti i Komunës kishte të dizajnuar një sistem të kontrollit të brendshëm, megjithatë kontrollet kishin funksionuar dobët gjatë vitit 2013. Në veçanti janë identifikuar këto çështje:

- Prezantim jo i plotë i pasurive, që pasqyron dobësi në kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë dhe regjistrimin e saktë të pasurive;
- Një numër lëshimesh dhe pasaktësishë (për shembull) në vitin e kaluar, pasuritë nën 1,000€, në vlerë prej 633,000€, nuk ishin paraqitur në Pasqyra vjetore financiare;
- Dobësi në klasifikimin e shpenzimeve në mes të investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve;
- Mungesa e një procesi sistematik për menaxhimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Nivel i ulët i ekzekutimit të buxhetit (81% shkalla e përgjithshme, 71% për investime kapitale). Kjo mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të Komunës dhe financimin e projekteve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm;
- Një sërë dobësish në procedurat e mbledhjes së të hyrave, gjë që ka shpie në rritjen e vlerave të të arkëtueshmeve;
- Nevoja për t'i shtuar kontrollet mbi shpenzimet, veçanërisht në fushën e prokurimit dhe te subvencionet dhe

Funksioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nuk ofron sigurinë e pritur mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme për menaxhmentin. Komiteti i Auditimit nuk adreson në mënyrë proaktive performancën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Komuna e Prishtinës është zotuar dhe ka filluar të punojë në planin e veprimit, që do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

INVESTIMET KAPITALE

DREJTORIA E ADMINSTRATËS

Renovimi i objekteve të bashkësive lokale dhe Administratës komunale	Planifikuar për 6-mujorin e dytë
Projektet me bashkëfinancim	Planifikuar për 6- mujorin e dytë
Pajisje kompjuterike dhe softuerë aplikativë	Përfunduar
Furnizimi me inventar, sipas nevojave të Administratës komunale	Në proces

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Ndërtimi i rrugës në fshatin Grashticë, lagja "Halilaj"	Ka përfunduar
Ndërtimi i rrugës nga rruga magjistrale Prishtinë – Gjiilan	Në përfundim e sipër nuk ka aktivitete të punës për shkak pengesave të banorëve të lagjes- problemeve private pronësore. Deri më tani janë përfunduar rrjetet e kanalizimit fekal dhe atmosferik me gjatësi 550 m, rrjeti i ujësjellësit dhe trotuaret e trupit të rrugës në të dy anët.
Asfaltimi i rrugës në fshatin Rimanishtë, lagja "Balaj" dhe në Dabishevc	Ka përfunduar
Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku" - krahu i dytë, djathtas	Punimet janë pezulluar për shkak se trupi i rrugës tangon ne një objekt individual. Janë përfunduar rrjetet e kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjeti i ujësjellësit dhe trotuaret e

	trupit të rrugës në të dy anët.
Ndërtimi i rrugës "Trepça"	Në përfundim e sipër - është përfunduar kanalizimi fekal, atmosferik si dhe ujësjellësi. Ekipi Mbikëqyrës edhe Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale kemi vendosur që rruga prej 350m të asfaltohet kurse pjesa tjetër e rrugës të punohet vetëm me zhavorr dhe të ndërpritet kontrata. Nëse nuk ja fillon edhe javën e ardhshme jemi të detyruar ta njoftojmë Drejtorinë e Prokurimit.
Ndërtimi dhe sanimi me zhavorr i rrugëve në fshatrat Koliq, Prapashticë dhe Dabishevc	Ka përfunduar
Ndërtimi i kanalizimit fekal në Bardhosh dhe ndërtimi i trotuareve, faza e dytë, ana e djathtë	Në përfundim e sipër është ndërtuar rrjeti i kanalizimit fekal – pastrimi i kanalizimit, ndërtimi i trotuarit të trupit të rrugës dhe shtresimi i zgjerimit të trupit të rrugës me asfalt.

Vazhdimi i ndërtimit të rrugës në Mat, prej përroit, me tre krahë	Në përfundim e sipër janë bërë shtresimet e trupit të rrugës me asfalt në dy shtresa në tre krahë të rrugës në Mat dhe katër krahëve në Zllatar.
Ndërtimi i rrugës “Enver Maloku” - pjesa e parë	Duke u punuar-gërmimi i gjerë i trupit të rrugës.
Ndërtimi i rrugëve dhe urave në fshatrat Hajvali , Llukar dhe Keqekollë	Duke u punuar - me ndërtimin e urrës betonarme në Sutesk dhe në Llukar. Në vitin 2013 janë bërë shtresimi i rrugëve në Keqekollë gjegjësisht lagjja Qelaj dhe Spahiaj
Asfaltimi i Unazës qendrore - pjesa perëndimore	Punimet janë pezulluar shkak të pengesave të paraqitura nga banoret gjegjësisht pritja e evakuimit të familjeve nga shtëpitë individuale që atakojnë trasenë.
Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut	Në përfundim e sipër ku vetëm pjesa e instalimeve elektrike ka mbetur pa u realizuar.
Rindërtimi i rrugëve “Remzi Demolli”, “Mihajlo Pupin”, “Zijaver Vllasaliu” dhe krahët e rrugës	Në përfundim e sipër
Rikonstruktimi i rrugëve “Hajrullah Avdullahu”, “Ferat Draga” dhe “Musine Kokollari”	Për momentin punimet janë pezulluar për

	shkak të pengesave të paraqitura nga banorët gjegjësisht pritja e evakuimit të familjeve nga shtëpitë individuale që atakojnë trasenë.
Rikonstruktimi i disa rrugëve me kubze dhe asfalt në Veternik dhe Bardhosh	Ka mbetur vetëm të bëhet pranimi teknik
Rregullimi i rrugës dhe kanalit të jashtëm të shkollës së mesme “28 Nëntori”	Ka përfunduar
Sanimi dhe rikonstruktimi i rrugëve në disa lagje të Prishtinës	Në përfundim e sipër
Sanimi i gropave në qytet	Ka përfunduar
Ndërtimi i disa rrugëve në lagjet “Janina” dhe “Qëndresa”	Në përfundim e sipër
Rikonstruktimi i disa rrugëve dhe trotuareve në lagjet e qytetit “Ulpiana” dhe “Dardania”	Në përfundim e sipër
Sanimi dhe konstruktimi i disa rrugëve në lagjen “Arbëria” dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Vranidoll	Në përfundim e sipër
Projektet e kontraktuara në vitin 2014	
Rindërtimi i rrugëve me asfalt dhe kubze në lagjet e Prishtinës	Në përfundim e sipër
Sanimi i kanalizimit fekal te sheshi “ Nëna Terezë “	Ka përfunduar
Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekal prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjeve “ Arbëria” dhe “Kodra e Trimave”	Duke punuar në bazë të planit dinamik
Ndërtimi i rrugës Siqevë - Sharban	Duke punuar në bazë të planit dinamik
Ndërtimi i rrugës Bërnice e Epërme – Sharban	Duke punuar në bazë te planit dinamik
Rregullimi i shtratit të lumit Prishtina – faza e parë, segmenti Fusha e Pajtimit – Makovc	Duke punuar në bazë të planit dinamik

Vazhdimi i rrugës lokale "VLORA" – Prishtinë, L= 226.77m'	Kanë filluar punimet
Sanimi i gropave në qytet	Duke punuar në bazë të planit dinamik
Projektet të cilat janë në fazën e tenderimit	
Kolektori betonarme për largimin e ujit atmosferik dhe kanalizimi fekale në rrugën mbi lumin "MAT" në lagjen Kalabria	
Ndërtimi i kanalizimit fekale prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjes "Arbëria" dhe " Kodra e Trimave", L= 7896.55 m'	
Rindërtim, sanimi i kanalizimeve fekale primare dhe sekondare si dhe rindërtimi, sanimi dhe zgjerimi i disa rrugëve sekondare në territorin e Komunës së Prishtinës	
Projektet të cilat do të tenderohen gjatë vitit 2014	
Ndërtimi i rrugës "STAMBOLLI" në lagjen "Arbëria"	
Ndërtimi i rrugës që lidhë rrethrotullimin me lagjen e Emshirit	
Ndërtimi i rrugës "Shaqir Igrishta" – segmenti i parë i rrugës	
Ndërtimi i rrugës paralele me rrugën "B" – segmenti i parë i rrugës	
Rrekonstruimi i pllatos së korrizit	

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHËPTIMIT

Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik (në parqe, hapësira të institucioneve komunale, montimi i trupave ndriçues LED, ndërrimi i shtyllave, montimi i ormanëve, qendra e monitorimit dhe ndriçimi solar)	Në proces të përgatitjes për tenderim
Ndërtimi i semaforëve	Në proces të përgatitjes për tenderim
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve dhe vendosja e numrave të shtëpive	Në proces të përgatitjes për tenderim
Rregullimi i vendeve të kontejnerëve dhe furnizimi me kontejnerë mbitokësorë, nëntokësorë dhe shporta	Planifikohet të përfundoj kah fundi i korrikut 2014
Furnizimi me makineri, pajisje dhe kamionë 16m ³ për bartjen e mbeturinave	Do të bëhet modifikimi i kamionëve ekzistues
Rregullimi i vendndaljeve - kabinave të autobusëve dhe rregullimi i infrastrukturës për transport (hartat orientuese)	Në proces të përgatitjes për tenderim

Shpimi i puseve dhe sistemi i ujitjes për gjelbërim	Në proces të përgatitjes për tenderim
Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe parqeve të qytetit	Do të dërgohet në KRPP për mundësin e dhënies së buxhetit Hortikulturës
Ndërtimi i deponisë për mbetje ndërtimore	Në procedurë për marrjen e lejes nga MAPL
Rregullimi dhe rrethojat për varreza	Në proces të përgatitjes për tenderim
Riparimi i ashensorëve me participim	Në proces të pranimit teknik
Tregu i kombinuar	Nuk realizohet për shkak se DUNMM nuk ka dhënë leje të ndërtimit dhe njëherësh është proceduar kërkesa për shkëputje të kontratës
Furnizimi me 50 autobusë të rinj për Trafikun Urban	Është pjesë e projektit me BERZH-in.

DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS

Shpronësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës	Gjysma e buxhetit e realizuar
--	-------------------------------

DREJTORIA E URBANIZMIT, NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Hartimi i planeve rregulluese ("Kodra e Trimave", "Vreshtat", "Velani-Dodona", "Bërnice e Ulët", "Bërnice e Epërme", "Bardhosh" etj.)	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Plotësimi dhe ndryshimi i planeve rregulluese të lagjeve "Tophane", "Dodona" dhe "Qendra 1"	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Hartimi i planit urbanistik-arkitektonik të Qendrës dhe sheshit të këmbësoreve (- Korridori i gjelbër) nga udhëkryqi te hoteli "Grand" deri te udhëkryqi te Katedralja katolike	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Përgatitja e projektit për riciklimin e mbeturinave	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Digjitalizimit i planeve - Projekti i GIS-it	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit

Hartimi i projekteve për (portat e qytetit të Prishtinës, Qendra Intermodulare, projektet e rrugëve të lagjeve të urbanizuara, rruga "A", lidhja e rrugës "B" dhe rrugës "A" me Unazën e brendshme, udhëkryqi për rrugën "Vëllezërit Fazliu" te Sharbanët dhe hartimi i projekteve për gjelbërimin e oborreve të shkollave dhe qendrave të Mjekësisë Familjare)	Realizuar gati në tërësi
---	--------------------------

DREJTORIA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Regjistrimi kadastral i përvojave, objekteve nëntokësore dhe kadastrit etazhor i ndërtesave	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Krijimi i kadastrit të varrezave të qytetit	Nuk mund të realizohet - nuk ka ligj për varreza
Krijimi i kadastrit të sinjalizimit vertikal të komunikacionit	Nuk realizohet pasi që AKK nuk ka krijuar kushte - regjistër për përpunimin e këtyre të dhënave.
Rikonstruktimi i informacionit kadastral	Nuk realizohet këtë vit - realizohet në vitin 2015

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ndërtimi i këndeve të lodrave për fëmijë në lagje të kryeqytetit	Është duke u përgatitur për tenderim
Teatri i Qytetit të Prishtinës	Po mendohet për lokacionin e mundshëm
Muzeu i Eksodit	Do të tenderohet për hulumtim
Salla universale kulturore dhe Galeria e qytetit	Po mendohet për lokacionin e mundshëm
KUDO - Art në hapësira urbane publike	Është duke u përgatitur për tenderim
Ndërtimi i pishinës së mbyllur në Parkun Gërmia (afër pishinës ekzistuese)	Është duke u përgatitur për tenderim
Ndërtimi i fushave sportive në komunën e Prishtinës (qytet dhe vise rurale)	Është duke u përgatitur për tenderim
Skate - park	Është duke u përgatitur për tenderim
Qendra sportive rekreative në zonat rurale	Është duke u përgatitur për tenderim
Inventar dhe pajisje për institucione kulturore dhe sportive	Grumbullim të dhënash për tenderim

Ndërtimi i terrenit për basketboll në fshatin Bardhosh, Hajvali dhe në lagjen "Vreshta" në Prishtinë	Është duke u përgatitur për tenderim
--	--------------------------------------

DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Projekte me bashkëfinancim dhe promovim	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Këshillimet e bizneseve - Vauqeret	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Projekti diaspora – nxitja e investitorëve nga diaspora	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Promovimi i bashkëpunimit ekonomik me qytetet tjera nga vende të ndryshme	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Promovimi i punësimit të të rinjve - trajnimet në ndërmarrësi nëpërmjet programit të praktikës intership	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Promovimi i bizneseve - udhërrëfytes	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit
Tryeza debatuese e bizneseve	Planifikuar për pjesën e dytë të vitit

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Ndërtimi i institucioneve shëndetësore me infrastrukturë përcjellëse	Është në punim e sipër
Ndërtimi i objektit banesor kolektiv për familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të UÇK-së.	Ka përfunduar.
Ndërtimi i objektit banesor kolektiv social dhe për nevoja të shpronësimit	Në përfundim e sipër
Pajisje mjekësore	Në fazën e fundit të përpilimit të specifikacioneve nga mjekët
Renovime, përmirësim i infrastrukturës së objekteve shëndetësore dhe sociale	Janë bërë të gjitha analizat në teren dhe materiali është duke u përgatitur nga Drejtoria e Urbanizmit
Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe sociale	Ka përfunduar
Dezinsektimi hapësinor	Deri me tani janë realizuar dy nga katër fazat e kontraktuara
Deratizimi vjeshtor i bodrumeve dhe garazheve	Ka përfunduar faza e dytë (katër faza)

Deratizimi i kanalizimit	Ka përfunduar faza e tretë (katër faza)
Furnizimi me dy autoambulanca, me pajisje mjekësore për nevojat e QKMU-së	Në procedurë e sipër
Furnizimi me automjete - autoambulanca për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe sociale	Në procedurë e sipër
Ndërtimi i Qendrës për qëndrim ditor të personave me aftësi të kufizuar	Pritet të caktohet lokacioni dhe pastaj të fillohet me procedurat.

DREJTORIA E ARSIMIT

Ndërtimi i ShF në lagjen "Kalabri"	Pezulluar - Problem pronësor.
Ndërtimi i ShF në lagjen "Arbëri"	Pezulluar - Problem pronësor.
Ndërtimi i ShMM "Prek Jakova"	Ndërprerja e punimeve deri në një vendim
Rikonstruktimi i objektit të vjetër të gjimnazit "Eqrem Çabej" dhe ridestinimi për objekt të ShF në Sofali, ndërtimi i sallës së edukatës fizike	Është dërguar kërkesa dhe projekti në prokurim për tenderim.
Ndërtimi i objektit të sallës së edukatës fizike - ShF "Shkëndija" në Hajvali	Është bërë tenderimi i këtij projekti.
Rikonstruktimi i objektit të ShF "Elena Gjika" në Prishtinë	Është bërë përgatitja e projektit dhe pritet të bëhet shpallja e tenderit.
Ndërtimi i fushave sportive në disa shkolla	Është duke u përgatit projekti për tenderim.
Rregullimi i oborreve dhe ndërtimi i rrethojave të shkollave	Është duke u përgatitë projekti për tenderim.
Rikonstruktimet dhe gëlqerosja e shkollave	Është bërë shpallja e ofertuesve pritet fillimi i punimeve
Pajisjet me kabinete, inventar shkollor dhe me libra për biblioteka shkollore	Është bërë shpallja e tenderit për pajisje të sallave, kabineteve si dhe pritet shpallja e tenderit për inventar.
Instalimet e reja dhe renovimet e ngrohjes qendrore	Pritet shpallja e tenderit për pajisje të shndërrimit të kaldajave nga nafta
Funksionalizimi i qendrave për ngritje profesionale	Është bërë shpallja e tenderit për qendrat e trajnimeve në ShF Shkolla e Gjelbër dhe Dardania